



Prishtinë: 28.03.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1130_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1892_01_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **25.02.2019**.

në seancën e mbajtur më datë 28.03.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A. O. nga Lipjani, me shifër të konsumatorit DFE - 56168, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1892_01_19** i datës 31.01.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 25.02.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se sipas procesverbalit të instalimit të njësorit nr.030140 me gjendje A1=3166 kWh dhe A2=1188 kWh konkludohet se në kohën e kyçjes në rrjet ka pasur këtë gjendje, ndërsa faturimi është bërë me gjendja A1=58719 kWh dhe A2=1188 kWh. KESCO në ankesë ka theksuar se sipas qendrës së kalibrimit njehsori ka rezultuar në rregull dhe se regjistrimi dhe shpenzimi ka qenë në rregull. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1892_01_19 i datës 31.01.2019 për konsumatorin A. O. me shifër DPZ - 9054767 dhe të mbetet në fuqi korrigjimi shtesë në vlerë prej 4343.01 € dhe 599.38€.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s sipas procesverbalit të instalimit të njësorit nr.030140 me gjendje A1=3166 kWh dhe A2=1188 kWh konkludohet se në kohën e kyçjes në rrjet ka pasur këtë gjendje, ndërsa faturimi është bërë me gjendja A1=58719 kWh dhe A2=1188 kWh, Bordi i ZRRE thekson se në procesverbalin e inspektimit nr.1285551 të datës 21.07.2014 përveç të dhënave të njehsorit elektrike nr.030140 me gjendje TL=03160 kWh dhe TU=01188 kWh, është theksuar se ky njehsor



elektrik është në shifrën e vjetër 142289 dhe se njehsori duhet të aktivizohet. Po ashtu Bordi i ZRRE ka analizuar edhe procesverbalin e pranimit e instalimit elektrik nr.042963 i datës 21.07.2014 dhe se edhe në këtë procesverbal është theksuar se duhet të bëhet aktivizimi i njehsorit te konsumatori. Pra Bordi i ZRRE thekson se njehsori elektrik kontestues përveç shifrës DPZ – 905767 që ka qenë i regjistruar edhe në shifrën e vjetër DPZ – 142289 të cilën vet KEDS e pohon përmes procesverbaleve të saja. Bordi i ZRRE po ashtu potencon se është e saktë se njehsori elektrik nr.030140 me rastin e pranimit të tij dhe inspektimit të datës 21.07.2014 ka qenë TL=03166 kWh dhe TU=01188 kWh, ndërsa me rastin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr.0152279 të datës 16.10.2015 gjendja e shpenzimit ka qenë TL=058719 kWh dhe TU=01188 kWh, por që gjatë analizës së këtyre procesverbaleve të vet KEDS-it shihet qartë se në tarifën e lartë kemi dallim në shpenzim, pra sipas këtyre procesverbaleve i bie se për periudhën 21.07.2014 e deri më 16.10.2015 (për afro periudhë 16 mujore) janë shpenzuar 55,559 kWh, apo mesatarisht për muaj janë shpenzuar 3472.06 kWh.

Bordi i ZRRE-së thekson se për të vërtetuar se shpenzimin e faturuar prej 55,559 kWh për periudhën 21.07.2014 e deri më 16.10.2015, organi i shkallës së parë ka kërkuar na KEDS që të sigurohen dokumente shtesë për rastin e konsumatorit, si transaksionet e konsumatorit, rrjedhën e energjisë elektrike aktive të shifrës së vjetër DPZ – 142289, si dhe procesverbalin e pasivizimit të njehsorit elektrik nr.30140 për të parë saktë gjendjen me të cilën është pasivizuar njehsori elektirk nr.30140. Bordi i ZRRE thekson se edhe në vendimin e organi të shkallës sp parë e poashtu edhe në ankesën e KESCO drejtuar Bordit, nuk janë siguruar dokumentacioni i kërkuar shifrës së vjetër DPZ – 142289, por janë siguruar dy dokumente në të cilën evidentohet se njehsori elektrik nr.30140 ka qenë i regjistruar në shifrën DPZ – 142289, por që me çfarë gjendje të shpenzimit nuk është evidentuar.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO se sipas qendrës së kalibrimit njehsori ka rezultuar në rregull dhe se regjistrimi dhe shpenzimi ka qenë në rregull, Bordi i ZRRE-së thekson se sipas protokollit të shqyrtimit të njehsorit nr.664 të datës 13.01.2016 njehsori elektrik është brenda kufijve të matjes të bëra në numërues, dhe se nuk mund të merren matjet në LED diodë pasi që LED dioda nuk mund të komunikojë me foto koke. Gjithashtu në procesverbal është theksuar se njehsori elektrik nuk është në rregull, njehsori elektrik nuk është i djegur, njehsori elektrik nuk është i dëmtuar nga ana e jashtme, dhesë nuk ka probleme me sistemet matëse, njehsori elektrik i ka bllokat shtetërore, etj. Bordi i ZRRE thekson se në këtë procesverbal është theksuar se njehsori elektrik nuk është në rregull, por që nuk kanë evidentuar çka nuk është në rregull, përveç konstatimit se njehsori elektrik është brenda kufijve të matjes të bëra në numërues, nuk mund të merren matjet në LED diodë pasi që LED dioda nuk mund të komunikojë me foto koke. Pra Bordi i ZRRE thekson se bazuar në këto shkresa shihet qartë edhe këtu se njehsori elektrik nr.030140 nuk ka qenë në rregull. Në pikën e kundërshtimit se regjistrimi dhe shpenzimi ka qenë në rregull, Bordi i ZRRE-së thekson se kjo nuk është e saktë, pasi që bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike të konsumatorit vërehet se konsumatori nga periudha e regjistrimit të njehsorit elektrik nuk ka shpenzim të energjisë elektrike të regjistruar, përveç periudhës 06/2015 dhe 07/2015 të cilat fatura janë me faturim pa matje/paushall, si dhe periudha 04/2017 dhe 08/2017 e të cilat janë me matje. Pra, nga periudha 21.07.2014 e deri më 08/2018 vërehet qartë se konsumatori nuk ka shpenzim të faturuar (përveç periudhave të cekura më lartë), por ka vetëm faturim të taksave dhe nuk ka shpenzim. Bazuar në rrjedhën e energjisë shihet qartë se është e pa argumentueshme se si janë shpenzuar 55,553 kWh për periudhën 21.07.2014 e deri më 16.10.2015 siç theksohet edhe në përgjigjen e KESCO-s, kur shihet qartë se konsumatori si me njehsori nr.030140 apo edhe me njehsori elektrik nr. 64097241 nuk ka pothuajse fare shpenzim të energjisë elektrike

Bordi i ZRRE bazuar në të gjitha shkresat e lëndës thekson se shifra e konsumatorit DPZ – 9054767 për herë të parë është regjistruar me datë 25.07.2014 me taksën për shërbime si lidhje e re prej 116.00€ dhe me këtë është regjistruar njehsori elektirk nr.030140 e me gjendje TL=5 kWh dhe TU=5 kWh, e që bie në kundërshtim me procesverbalin e pranimit të instalimit elektrik nr.042963 të datës 21.07.2014,



ku gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike ka qenë TL=03166 kWh dhe TU=01188 kWh. Vlen të theksohet se konsumatorit i është bërë aktivizimit i njehsorit elektrik nr.030140, por jo në shifrën e vjetër DPZ – 142289 siç është theksuar në procesverbalet e vet KEDS-it, por në shifrën DPZ – 9054767. Bordi i ZRRE-së poashtu thekson se KESCO me datë 06.03.2017 e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjim shtesë nr.50110DPZ-9054767-9054767 në vlerë prej 599.38 kWh dhe nr.50109DPZ-9054767-9054767 në vlerë prej 4,343.01€, ndërsa ndërimi i njehsorit elektrik ka ndodhur me datë 16.10.2015, dhe se korrigjimi financiar i datës 08.03.2017 ka ndodhur për shkak të gjendjes së shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit elektrike të bërë me rastin e ndërrimit të njehsorit elektrik. Pra, nga kjo shihet qartë se KESCO-s i është dashur përafro 18 muaj (16.10.2015 e deri më 08.03.2017) që ta ngarkoj konsumatorin me këtë ngarkesë shtesë dhe për këtë nuk ka dhenë asnjë informatë se pse ka ndodhur kjo. Bordi i ZRRE potencon qartë se KEDS ka dështuar t'i siguroj ZRRE dëshmitë e pasivizimit të shifrës së vjetër DPZ – 142289 për të parë se me çfarë gjendje të shpenzimit është pasivizuar njehsori nr.030140, andaj edhe konstaton se KEDS/KESCO nuk ka respektuar nenin 28 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: **"1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja, dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara) ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim".**

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit A. O. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.